



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
DREJTORIA E PROKURIMEVE PUBLIKE DHE INVESTIMEVE

Nr. _____ prot.

Elbasan, më ____ . ____ .2026

LËNDA: Dërgim njoftimi për botim në Buletinin e Prokurimit Publik.

AGJENCISË së PROKURIMIT PUBLIK

TIRANË

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT, PAS PUBLIKIMIT TË TË CILIT FILLOJNË
AFATET E ANKIMIMIT

Nga: **Bashkia Elbasan** adresa: rruga “Qemal Stafa”, Elbasan

Drejtuar: “ **ERA TRAVEL 2013 ERA TRAVEL 2013** ” sh.p.k. me nipt L 33122201 P ,
me adrese, Elbasan Lagjja 28 Nentori, rruga Esat Bordi, Zyrat brenda "Pallatit te sportit".

Bashkimit të Operatorëve Ekonomikë (BOE)

- OE/BOE me nënkontraktor

PO JO

-OE/BOE me Subjekt Mbështetës:

PO JO

Tipi i Kontratës: Sherbim

Lloji i Procedurës së prokurimit: Procedurë e Hapur e Thjeshtuar

Numri i referencës së procedurës/lotit: REF-82267-04-16-2026

Përshkrim i shkurtër i kontratës: “Sherbimi i transportit te nxenesve ne kuader te pjesemarrjes ne programin TUMO TIRANA”, me fond limit 2,426,666 (dymilion e katerqind e njezet e gjashtemije e gjashteqind e gjashtedhjetete e gjashte) lekë pa t.v.sh.

Data e Publikimit të Njoftimit të Kontratës në SPE: 17.04.2026

Data e Publikimit të Njoftimit të Kontratës në Buletinin e Njoftimeve Publike : data 20.04.2026,
Buletini Nr.28

KRITERET E PËRZGJEDHJES SË FITUESIT:

- oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në kosto
- oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim

Me anë të këtij Formulari ju informojmë se, në këtë procedurë/lot kanë marrë pjesë, Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

1. “ERA TRAVEL 2013 ERA TRAVEL 2013” sh.p.k. me Nipt: L 33122201 P

Vlera e paraqitur në këtë procedurë është **2,426,000** (dymilion e katerqind e njetzet e gjashtëmije) **lekë pa t.v.sh.**

OE/BOE me nënkontraktor

PO JO

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

2. “LU-NA” sh.p.k. me Nipt: K 31412087 P

Vlera e paraqitur në këtë procedurë është **2,197,440** (dymilion e njeqind e nentedhete e shtatemije e katerqind e dyzet) **lekë pa t.v.sh.**

OE/BOE me nënkontraktor

PO JO

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

Nga pjesëmarrësit janë s’kualifikuar, Ofertuesit e mëposhtëm:

“LU-NA” sh.p.k.

1. Ne permbushje te kriterëve te pergjithshme te kualifikimit te percaktuara ne shtojcen 9 te DST-se keni paraqitur shtojcen 10 “FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT”. Ne Pjesa II: Shkaqet e përjashtimit A: DEKLARATA PËR PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME TË KUALIFIKIMIT nder te tjera keni deklaruar:

Personi / personat në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtorit ose mbikëqyrësit, si aksionar ose si ortak, ka ose kompetenca përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, si më poshtë: **B.R** nuk janë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për ndonjë nga veprat penale të përcaktuara në nenin 76/1 të LPP-së ose kanë qenë të dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së, etj. Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme : I padenuar për veprat penale të parashikuara në nenin 76/1 të LPP-së.

Nga verifikimi i ekstraktit të QKB-së të operatorit tuaj ekonomik rezulton se përveç z.B.R janë edhe 6 ortakë të tjere (L.N., G.L., L.LL., T.LL., E.LL., E.R.), për të cilët nuk është bërë deklarimi i mesiperm.

Në shtojcën 10 **“FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT” pjesë DST-se nder të tjera përcaktohet:**

- **Çdo vetdeklarim i pavërtetë/pasaktë nga ana e operatorëve ekonomikë jo vetëm që përbën shkak për skualifikimin nga procedura konkrete, por përbën shkak dhe për përjashtimin e tyre nga e drejta për të fituar kontrata publike deri në 3 vjet, sipas parashikimeve të ligjit për prokurimin publik.**

Në nenin 82 të LPP-së nder të tjera përcaktohet se :

1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik.

Në nenin 26 të VKM 285, dt.19.05.2021 **“Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, nder të tjera përcaktohet:**

1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla.

2. Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit përmban informacion dhe deklarimin, si më poshtë vijon:

c) personi/at në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionarit ose ortakut, ose që ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, nuk është ose ka qenë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për asnjë nga veprat penale, të përcaktuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së;

7. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik, si më sipër, ose t'i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

Ne nenin 76 pika 1 te LPP-se percaktohet:

1. Çdo operator ekonomik që është ose ka qenë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për ndonjë nga veprat penale të përmendura në këtë pikë, skualifikohet nga procedurat e prokurimit publik për një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata. Ky skualifikim bëhet për veprat penale të mëposhtme:

- a) pjesëmarrje në grup të strukturuar kriminal, organizatë kriminale, bandë e armatosur, organizatë terroriste, sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi;
- b) korrupsion sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi;
- c) mashtrim sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi;
- ç) pastrim parash ose financim të terrorizmit sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi;
- d) vepra me qëllime terroriste ose vepra penale të lidhura me veprimtari terroriste, sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi;
- dh) falsifikim;
- e) puna e fëmijëve dhe forma të tjera të trafikimit të qenieve njerëzore sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi.

Detyrimi për skualifikimin e një operatori ekonomik zbatohet edhe kur personi i dënuar me një vendim gjyqësor të formës së prerë është anëtar i një organi administrimi, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, operatori ekonomik, ose ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij.

Ne piken 3 te nenit 92 te LPP-se percaktohet:

3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji.

Sa me sipër, operatorët ekonomikë janë të detyruar të paraqesin ofertat në përputhje me udhëzimet dhe kërkesat në dokumentet e tenderit dhe në zbatim të LPP. Çdo ofertë e cila nuk është dorëzuar në përputhje me kërkesat në dokumentet e tenderit do të refuzohet si e pa vlefshme.

Operatori ekonomik, nuk ka dhënë të dhënat e nevojshme për rubrikat e cituara më sipër sic ky formular parashikon duke mos plotësuar kriteret e përgjithshme të kualifikimit, lidhur me plotësimin e saktë të shtojcës 10, sipas kërkesave të Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, pjesë e dokumenteve të tenderit. (Ky është edhe qendrimi i konsoliduar tashme edhe nga KPP, shiko vendimin nr.521/2026).

2. Ne permbushje te kriterit 2.3.2 te kapacitetit Teknik keni paraqitur Licencen per kryerjen e sherbimeve te rregullta te specializuara, te transportit te udhetareve brenda vendit .

3. Ne permbushje te kriterit 2.3.3 te kapacitetit Teknik keni deklaruar ne shtojcen 10 “FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT”, si dhe keni paraqitur dokumentacionin e kerkuar per disponimin e dy autobuseve, pjese e te cilit, eshte edhe certifikata e operimit e leshuar per autobuset per kryerjen e sherbimeve te rregullta te specializuara sipas licences se paraqitur ne permbushje te kriterit 2.3.2.

Nga permbajtja e licences dhe certifikates se operimit per secilin autobus rezulton se licenca dhe certifikatat jane leshuar per sherbimet e rregullta te specializuara sipas kontrates se lidhur me institucionin arsimor “Green Education” apo me subjektin “Abi Esse”, me afat vlefshmerie te certifikatave 17.07.2025-17.07.2026 dhe 04.12.2025-04.12.2026.

Pra te dy autobuset e deklaruar, dhe per te cilet eshte paraqitur dokumentacioni i kerkuar nuk jane te disponueshem pasi OE ka lidhur kontrata me institucionin arsimor “Green Education” apo me subjektin “Abi Esse” per transport nxenesish apo punonjesish. Per me teper qe nje nga ditet kur kerkohet sherbimi eshte te premten nga ora 10⁰⁰ - 15¹⁵.

Ne nenin 23/1 te ligjit 8308, date 18.03.1998 “Per transportet rrugore”, i ndryshuar, nder te tjera percaktohet se:

Shërbimet e rregullta të specializuara janë shërbime, të cilat përfshijnë:

- a) **transportin shtëpi-punë të punonjësve;**
- b) **transportin shtëpi-institucion shkollor të nxënësve dhe studenteve;**
- c) transportet qytetëse kufitare, kur lejohen me marrëveshje ndërkombëtare.

Shërbimet e rregullta të specializuara kryhen me autobus.

Ne nenin 5 te Udhzimit te ministrit te Transportit dhe Infrastruktures nr.5627 date 18.11.2016 “PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE, RREGULLAVE DHE DOKUMENTACIONIT PËR LËSHIMIN E LICENCAVE DHE CERTIFIKATAVE PËR USHTRIMIN E VEPRIMTARISË NË TRANSPORTIN RRUGOR TË UDHËTARËVE BRENDA VENDIT”, i ndryshuar, nder te tjera percaktohet se:

Shërbimet e rregullta të specializuara përfshijnë transportin:

- a) **shtëpi – punë, të punonjësve;**
- b) **shtëpi – institucion shkollor, të nxënësve dhe studentëve;**

Në rast se përdoruesi i një shërbimi të rregullt të specializuar, për nevojat e tij, kërkon të ndryshojë në mënyrë të përhershme itinerarin e një shërbimi të rregullt të specializuar, ai duhet të aplikojë tek autoriteti i licencimit, për kryerjen e veprimeve të nevojshme.

Shërbimet e rregullta të specializuara brenda vendit janë subjekt licencimi, si dhe kanë detyrimin të lidhin një kontratë ndërmjet organizatorit të transportit dhe subjektit, e cila shërben si dokument kontrolli për këto shërbime.

Shërbimet e rregullta të specializuara kryhen brenda territorit juridik të bashkisë ku përfshihen të gjitha njësitë administrative përbërëse.

Në rast se destinacioni i këtij shërbimi del jashtë juridiksionit të një bashkie ku ndodhet pika e nisjes, shërbimi kryhet vetëm pas një marrëveshje bashkëpunimi të lidhur midis bashkisë si pikë nisje dhe bashkisë së destinacionit, si pikë mbërritje.

Ne VKM nr. 89, date 14.02.2018 “Per miratimin e kushteve dhe percaktimin e rregullave per transportin rrugor te nxenesve te arsimit parashkollor, profesional parauniversitar dhe te studenteve” pika 3 “Perkufizime”, nder te tjera parashikohet se:

ç)“Licencë”, akti administrativ i lëshuar për një periudhë të caktuar kohe, i vlefshëm për të ushtruar

veprimtari transporti udhëtarësh.

d)“Certifikatë”, dokumenti që mbahet në mjet gjatë udhëtimit dhe që:

i) shoqëron licencën për rastet e transporteve rrugore që janë subjekt licencimi;

ii) i jep të drejtën një institucioni arsimor për transportin për llogari të vet të nxënësve të arsimit

parashkollor, profesional parauniversitar dhe të studentëve.

dh)“Shërbimet e rregullta të specializuara”, shërbimet që sigurojnë transportin:

i) shtëpi – institucion parashkollor (kopshti i fëmijëve) dhe anasjelltas, sipas përcaktimeve të pikës 7.4, të kësaj rregulloreje;

ii) shtëpi – institucion shkollor ose universitet dhe anasjelltas, i parauniversitarëve dhe i studentëve, sipas përcaktimeve të pikës 7.4.

Ne VKM nr. 89, date 14.02.2018 “Per miratimin e kushteve dhe percaktimin e rregullave per transportin rrugor te nxenesve te arsimit parashkollor, profesional parauniversitar dhe te studenteve” pika 4 “Licenca dhe certifikata”, nder te tjera parashikohet se:

4.1 Janë subjekt licencimi dhe certifikimi personat fizikë ose juridikë që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në fushën e transportit për:

a) shërbimet e rregullta, përfshirë shërbimet e rregullta të specializuara për nxënësit e arsimit parashkollor, profesional parauniversitar dhe studentët;

b) shërbimet e rastit;

c) transportet për llogari të vet, të nxënësve të arsimit parashkollor, profesional parauniversitar dhe të studentëve.

4.2 Licenca lëshohet në bazë të nenit 5, të ligjit nr. 8308, datë 18.3.1998, “Për transportet rrugore”, të ndryshuar, dhe të vendimit nr. 325, datë 19.3.2008, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullave për pranimin në veprimtarinë e operatorit të transportit rrugor të mallrave dhe të udhëtarëve, si dhe për njohjen e dokumenteve zyrtare, të caktuara për këta operatorë”, të ndryshuar.

4.3 Shërbimet e rregullta, përfshirë shërbimet e rregullta të specializuara dhe shërbimet e rastit, janë subjekt i licencës së lëshuar nga autoriteti kompetent sipas pikës 5, të kësaj rregulloreje.

4.4. Autoriteti kompetent i lëshimit të licencës lëshon certifikata për çdo mjet që është në përdorim,

edhe nëse këto mjete janë pronë e institucionit arsimor apo të marra me qira.

4.5. Çdo mjet është i pajisur edhe me certifikatën e operimit, e cila është dhe pjesë përbërëse e kontratës së lidhur ndërmjet transportuesit dhe institucionit.

Ne VKM nr. 89, date 14.02.2018 “Per miratimin e kushteve dhe percaktimin e rregullave per transportin rrugor te nxenesve te arsimit parashkollor, profesional parauniversitar dhe te studenteve” pika 6 “Kushtet që duhet të plotësojë mjeti i transportit”, nder te tjera parashikohet se:

6.9. Subjektet transportuese që kryejnë transport të nxënësve të arsimit parashkollor, profesional parauniversitar dhe universitar mund të kryejnë shërbime të tjera vetëm nëse janë të pajisura me certifikata operimi për ato shërbime, siç parashikohet nga legjislacioni në fuqi.

6.10. Asnjë subjekt nuk mund të japë ose të marrë me qira një automjet të destinuar për shërbime të rregullta të specializuara të nxënësve të arsimit parashkollor, profesional parauniversitar dhe të studentëve, nëse subjekti nuk është i pajisur me licencë për të tretë në transportin e udhëtarëve.

6.11. Certifikata e operimit, e lëshuar për një automjet të destinuar për shërbimet e rregullta të specializuara për parashkollorët, parauniversitarët dhe studentët, lëshohet në emër të subjektit të transportit.

6.12. Certifikata e operimit, e lëshuar për një automjet të destinuar për shërbimet e rregullta të specializuara për nxënësit e arsimit parashkollor, profesional parauniversitar dhe studentëve, lëshohet me afat pesëvjeçar dhe nuk është e transferueshme. Në certifikatën e operimit vendoset itinerari që përshkruan automjeti, e shoqëruar me vendndalimet përkatëse.

Oferta juaj refuzohet per arsyet e mesiperme.

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë operatorin ekonomik **“ERA TRAVEL 2013 ERA TRAVEL 2013” sh.p.k.**, me adresë: Elbasan Lagjja 28 Nentori, rruga Esat Bordi, Zyrat brenda "Pallatit te sportit", me nipt. **L 33122201 P**, se oferta e paraqitur me vlerë totale prej **2,426,000** (dymilion e katerqind e njezet e gjashtemije) **lekë** (pa tvsh), është identifikuar si ofertues i sukseshëm.

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 110 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar.

**TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR
PERSONI I AUTORIZUAR PREJ TIJ
ZV. KRYETARI
Asim Sula**